

FOL

Dhuratat e pranuarra nga zyrtarët e institucioneve të pavarura të Kosovës

(janar - dhjetor 2023)



**Dhuratat e pranuarra
nga zyrtarët e
institucioneve
të pavarura të
Kosovës**

TITULLI:

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e institucioneve të pavarura të Kosovës (janar - dhjetor 2023)

AUTORË:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

2024

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

Përmbajtja

Hyrje _____	06
Metodologjia _____	07
1. Baza ligjore e deklarimit dhe kontrollit të dhuratave ____	08
2. Dhuratat e pranuar nga zyrtarët publik të institucioneve publike (janar - dhjetor 2023) _____	11
Të dhënat e pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023 _____	12
3. Dhuratat e pranuar nga zyrtarët publik të Institucioneve të Pavarura Publike _____	14
- Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) _____	14
- Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit _____	15
- Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) _____	15
- Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Doganës së Kosovës _____	16
- Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës ____	17
4. Konkluzion _____	18
5. Rekomandime _____	19

Hyrje

Deklarimi i dhuratave dhe pasurisë është një mekanizëm themelor në luftën kundër korrupsionit, duke shërbyer si një mjet i fuqishëm për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në sektorin publik. Ky proces ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit, duke garantuar që zyrtarët publik të mos përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga pozitat e tyre.

Përmes deklarimit të rregullt të pasurisë dhe dhuratave krijohet një kulturë e ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë, duke ndihmuar në ndërtimin e besimit të publikut tek institucionet. Në të njëjtën kohë, sistemi i deklarimit të pasurisë dhe dhuratave siguron një bazë të rëndësishme për organet mbikëqyrëse dhe hetimore për të monitoruar dhe kontrolluar burimet e të ardhurave dhe shpenzimeve të zyrtarëve publik. Kjo mundëson një analizë më të hollësishme dhe të thelluar të lëvizjeve financiare dhe përputhshmërinë e tyre me standardet etike dhe ligjore.

Përveç kësaj, mekanizmi i deklarimit të pasurisë dhe dhuratave luan një rol të rëndësishëm në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut rreth rëndësisë së transparencës dhe integritetit. Kur qytetarët janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për rëndësinë e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, ata janë më të gatshëm të mbështesin dhe të kërkojnë zbatimin e rregullave dhe standardeve etike.

Ky raport synon të analizojë në mënyrë të detajuar nivelin e zbatimit të dispozitave ligjore nga disa prej institucioneve të pavarura të Kosovës, duke e trajtuar këtë si një prerogativë thelbësore në promovimin e integritetit dhe parandalimin e praktikave korruptive.

Duke shqyrtuar me kujdes legjislacionin ekzistues, mekanizmat e zbatimit të tij, raporti synon të identifikojë dobësitë dhe mangësitë e sistemit aktual, duke ofruar rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për përmirësimin e tij. Në këtë mënyrë, raporti kontribuon në ndërtimin e një mjedisi institucional më të fortë dhe më të qëndrueshëm, që mbështet transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe administratës publike.

Metodologjia

Ky raport ka për qëllim të sigurojë një analizë të detajuar të dhuratave protokollare dhe të rastit të pranuar nga zyrtarët e pesë institucioneve të pavarura të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023. Institucionet e pavarura të përzgjedhura për monitorim janë:

- **Banka Qendrore e Kosovës**
- **Zyra Kombëtare e Auditimit**
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**
- **Dogana e Kosovës**
- **Autoriteti i Konkurrencës**

Të dhënat e paraqitura në raport janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, drejtuar zyrtarëve përgjegjës të këtyre institucioneve. Kërkesa specifikoi nevojën për informacione në lidhje me numrin e zyrtarëve që kanë pranuar dhurata protokollare dhe të rastit, si dhe informacione mbi institucionet apo personat fizikë nga të cilët i kanë pranuar këto dhurata.

Raporti përmban edhe një analizë të dispozitave ligjore që e rregullojnë çështjen e pranimin të dhuratave, si dhe pasqyron të dhënat e pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në lidhje me numrin e institucioneve që kanë deklaruar pranimin e dhuratave dhe çështjet të tjera të nxjerra nga inspektimi për periudhën janar -dhjetor 2023.

1. Baza ligjore e deklarimit dhe kontrollit të dhuratave

Në korrik të vitit 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar Ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe i njëjti hyri në fuqi 6 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Hyrja në fuqi e këtij ligji e shfuqizoi Ligjin nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Kapitulli V i këtij ligji, i cili përfshinë nenet 22-26 të ligjit, rregullon çështjen e ndalimit të pranimit dhe kërkimit të dhuratave, njoftimin për pranimin dhe mbajtjen e dhuratave, si dhe evidentimin dhe kontrollin e regjistrit të dhuratave.

Neni 22

Ndalimi i pranimit dhe kërkimit të dhuratave

"Personi zyrtar nuk kërkon ose pranon, as për veten as për anëtarët e familjes, dhurata apo favore të tjera që lidhen me ushtrimin e detyrave zyrtare, dhe të cilat ndikojnë ose mund të kenë ndikim të perceptuar në ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave të protokollit ose dhuratave të rastit".

Pra parimisht, personit zyrtar nuk i lejohet të pranoj dhurata, qoftë për vetën apo familjarët, me përjashtim të dhuratave të protokollit apo të rastit.

Sipas ligjit, dhuratat e protokollit janë dhuratat e dhëna nga një përfaqësues i një vendi tjetër ose organizate ndërkombëtare gjatë një vizite ose rasti tjetër. Ndërsa dhuratat e rastit janë dhuratat e pranuar në ndonjë rast të veçantë që nuk ndërlidhen me ushtrimin e funksionit publik.

Neni 23

Pranimi i dhuratave të rastit

- 1. Personi zyrtar nuk pranon dhuratë të rastit, vlera e së cilës tejkalon shumën prej pesëdhjetë Eurove (50€), ose tërësia e dhuratave të rastit tejkalojnë shumën prej dyqind e pesëdhjetë Euro (250€) brenda një (1) viti".**
- 2. Personi zyrtar nuk pranon më shumë se një dhuratë të rastit në vit nga i njëjti person ose institucion.**
- 3. Personi zyrtar nuk pranon letra me vlerë monetare dhe metale të çmuara, pavarësisht nga vlera e tyre.**

Kjo dispozitë tregon se edhe numri i dhuratave të rastit nga personat zyrtarë është i kufizuar. Pra zyrtarët publik nuk pranojnë dhurata të rastit në vlerë më të madhe se 50 euro, apo kur vlera totale e tyre brenda 1 viti kalon shifrën prej 250 euro. Ky kufizim ka për qëllim të parandalojë ndikimin e jashtëm dhe përfitimet personale që mund të komprometojnë integritetin e zyrtarit publik.

Gjithashtu, sipas këtij neni, personi zyrtar nuk pranon më shumë se 1 dhuratë të rastit nga i njëjti person brenda vitit, ndërsa pranimi i letrave me vlerë monetare dhe metaleve të çmuara, është i ndaluar. Kjo masë është vendosur për të shmangur favorizimin ose marrëdhëniet e veçanta që mund të krijojnë një mjedis të korruptuar dhe të pandershëm.

Për më tepër, pranimi i letrave me vlerë monetare dhe metaleve të çmuara është rreptësisht i ndaluar, pasi këto dhurata mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm në vendimmarrjen e zyrtarëve publik.

Këto rregulla janë të dizajnuara për të mbrojtur integritetin e funksionarëve publik dhe për të siguruar që aktivitetet e tyre të jenë në përputhje me normat etike dhe ligjore. Duke kufizuar pranimin e dhuratave dhe duke vendosur kontrolle strikte mbi vlerën e tyre, synohet të krijohet një mjedis transparent dhe i përgjegjshëm që minimizon rrezikun e korrupsionit dhe abuzimit të pushtetit. Në këtë mënyrë, sigurohet që veprimet dhe vendimet e zyrtarëve publik të jenë të bazuara në interesin publik dhe jo në përfitimet personale.

Neni 24

Njoftimi për pranimin dhe mbajtja e dhuratës

1. Personi zyrtar, me rastin e pranimit të dhuratës, menjëherë e paraqet dhuratën për regjistrim tek zyrtari kontaktues institucionit përkatës.
2. Personi zyrtar e informon mbikëqyrësin e tij me shkrim nëse i është ofruar ose dhënë ndonjë dhuratë pa njoftim paraprak. Në rastet kur subjekti deklarues është drejtues i një institucioni, ai duhet të informojë Agjencinë.
3. Nëse dhurata e rastit nuk është e karakterit personal, dhurata bëhet pronë e institucionit në të cilin e ushtron detyrën personi zyrtar.
4. Dhurata protokollare është pronë e institucionit.
5. Dhuratat e protokollit që përfshijnë simbolet shtetërore, medalje dhe shenja të protokollit, mund të përdoren nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare.
6. Secili institucion ekspozon dhuratat e pranuar në një kënd të veçantë dhe të qasshëm nga palët dhe publiku.

Neni 24 i ligjit, pra, e rregullon çështjen e njoftimit për pranimin dhe mbajtjen e dhuratave nga ana e institucioneve publike. Sipas përmbajtjes së këtij neni, me rastin e pranimit të dhuratave, personi zyrtar menjëherë e paraqet për regjistrim tek zyrtari kontaktues i institucionit. Personi zyrtar obligohet të njoftoj mbikëqyrësin, ndërsa nëse subjekti deklarues është drejtues i institucionit, obligohet t'a informoj Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Gjithashtu, ky nen e rregullon edhe çështjen e pronësisë së dhuratave pas pranimit të tyre nga zyrtarët e institucioneve. Në të dy llojet e dhuratave që lejohen të pranohen, pra edhe në të rastit edhe në ato protokollare, dhuratat bëhen pronë e institucionit, me përjashtim të dhuratave të rastit me karakter personal. Gjithashtu, paragrafi i fundit i këtij neni i obligon institucionet që dhuratat ti ekspozojnë në një kënd të veçantë të qasshëm për publikun.

Neni 25

Regjistrimi i dhuratave

1. Të gjitha dhuratat e marra dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave ose institucioneve që japin dhurata, duhet të regjistrohen nga personi zyrtar në regjistrin e dhuratave të dizajnuar nga Agjencia dhe të mbahen nga institucioni në të cilin i ushtrorjnë detyrat e tyre personat zyrtarë. Regjistri mirëmbahet nga Zyrtari Kontaktues.
2. Me kërkesë të personit zyrtar që e ka pranuar dhuratën, Agjencia merr vendim për lejimin e pranimit të dhuratës nëse ka arsye bindëse për të besuar se dhurata është dhënë për qëllime personale dhe nuk ndikon as nuk duket të ketë ndikim në ushtrimin e detyrës zyrtare.
3. Institucionet përkatëse janë të detyruara të sigurojnë qasje publike në regjistrat e tillë, në përputhje me procedurat e parapara në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike.

4. Institucionet publike mbajnë regjistra të veçantë të dhuratave. Agjencia, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, harton formularin për mirëmbajtjen e regjistrave dhe ua përcjell institucioneve publike.
5. Agjencia ka të drejtën të kontrollojë regjistrat e dhuratave dhe në rast të ndonjë devijimi kërkon nga institucionet të marrin masa për zbatimin e plotë të këtij ligji.
6. Institucionet e kanë detyrim ligjor t'i mbajnë regjistrat e dhuratave për dhjetë (10) vite.
7. Të gjithë personat zyrtarë bëjnë deklarinimin e dhuratave duke plotësuar katalogun e dhuratave dhe të dorëzohen në institucionin ku zyrtari ushtron funksionin.

Neni 25 i ligjit e rregullon çështjen e procedurës së regjistrimit të dhuratave që pranohen nga zyrtarët e institucioneve, si dhe të dhënat që duhet të regjistrohen në regjistrin që dizajnohet paraprakisht nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, dhe që mirëmbahet nga zyrtari kontaktues i institucionit. Këto regjistra duhet të jenë të qasshme për publikun, konform ligjit.

Gjithashtu, ky ligj parasheh obligimin e institucioneve që këta regjistra ti mbajnë për dhjetë (10) vite.

Neni 26

Mbikëqyrja e dhuratave

Agjencia inspektin dhe auditon regjistrin e dhuratave dhe ruajtjen e këtyre të dhënave.

Neni i fundit i këtij kapitulli synon të siguroj një mekanizëm efektiv për mbikëqyrjen dhe auditimin e dhuratave të pranuar nga zyrtarët e institucioneve. Këto inspektime dhe auditime ligji i'a ka lënë në kompetencë Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, dhe e tërë kjo me qëllim të mbajtjes përgjegjës të zyrtarëve publik për veprimet e tyre, duke siguruar që ata të respektojnë rregullat dhe procedurat e përcaktuara.

2. Dhuratat e pranuara nga zyrtarët publik të institucioneve publike (janar - dhjetor 2023)

Për arritjen e objektivave të këtij raporti, Lëvizja FOL ka kërkuar të dhëna nga zyrtarët përgjegjës të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në lidhje me numrin e njoftimeve të pranuar nga institucionet për pranimin e dhuratave, numrin e kopjeve të katalogëve të dhuratave të pranuar, si dhe të dhëna të tjera të nxjerra nga inspektimi për periudhën janar-dhjetor 2023.

Këto të dhëna janë kërkuar me qëllim të sigurimit të një pasqyre të plotë dhe të detajuar mbi praktikën e pranimit të dhuratave nga zyrtarët publik. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të vlerësuar nivelin e integritetit dhe etikës në administratën publike, si dhe për të rekomanduar masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit aktual të kontrollit të dhuratave.

Të dhënat e pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023

Sipas përgjigjes së zyrtarëve të APK-së, të siguruara përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, ky institucion për vitin 2023 ka pranuar njoftimin nga 179 institucione publike në lidhje me çështjen e dhuratave, 14 prej të cilave kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa 165 kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak.

Periudha	Numri i institucioneve që e kanë njoftuar APK-në për çështjen e pranimit të dhuratave	Numri i institucioneve që kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata	Numri i institucioneve që kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata
Janar – dhjetor 2023	179	14	165

TABELA 1.

Numri i institucioneve që kanë njoftuar APK-në për çështjen e pranimit të dhuratave, si dhe numri i institucioneve që kanë deklaruar se kanë pranuar dhe nuk kanë pranuar dhurata.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti janë: Presidenca e Republikës së Kosovës; Kuvendi i Kosovës; Zyra e Kryeministrit; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Universiteti i Prizrenit; Ministria e Ekonomisë; Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Zyra Kombëtare e Auditimit; Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Akademia e Drejtësisë.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në APK, janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Nr.	Institucioni	Protokollare	Rastit	Numri i përgjithshëm
1	Presidenca e Republikës së Kosovës	67	-	67
2	Kuvendi i Kosovës	15	2	17
3	Zyra e Kryeministrit	67	92	159
4	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	-	1
5	Universiteti i Prizrenit	5	2	7
6	Ministria e Drejtësisë	-	2	2
7	Ministria e Ekonomisë	1	1	2
8	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	-	2	2
9	Ministria e Punëve të Brendshme	1	-	1
10	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	1	-	1
11	Zyra Kombëtare e Auditimit	2	3	5
12	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	14	-	14
13	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	7	-	7
14	Akademia e Drejtësisë	0	1	1
Gjithsej		181	105	286

TABELA 2.

Lista e institucioneve që kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, si dhe numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e këtyre institucioneve.

Në lidhje me obligimin e APK-së për të inspektuar institucionet në lidhje me mbajtjen dhe regjistrin e dhuratave gjatë vitit 2023, sipas të dhënave të pranuar divizioni për mbikëqyrjen e pasurisë dhe dhuratave ka vizituar dhe inspektuar vetëm 13 institucione publike.

Lista e institucioneve që janë inspektuar gjatë vitit 2023 nga APK janë:

→ Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a;

→ Posta e Kosovës Sh.a;

→ KOSTT Sh.a;

→ Hidromarava Sh.a;

→ Hidroregjioni Jugor Sh.a;

→ Ambienti Sh.a – Pejë;

→ KRU Mitrovica Sh.a, Mitrovicë;

→ Kompania Rajonale e Ujësjetjes Bifurkacion-Ferizaj;

→ Ndërmarrja Publike Lokale Ambienti Sh.a, Ferizaj;

→ Komuna e Mitrovicës së Veriut;

→ Komuna e Pejës;

→ Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren

→ Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan.

3. Dhuratat e pranuar nga zyrtarët publik të Institucioneve të Pavarura Publike

Për arritjen e objektivave të këtij raporti, Lëvizja FOL ka kërkuar informacione specifike në lidhje me numrin e zyrtarëve që kanë pranuar dhurata protokollare dhe të rastit në institucionet përkatëse, si dhe institucionin/personin fizik nga i cili i kanë pranuar dhuratat gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Këto të dhëna janë kërkuar nga 5 institucione publike të pavarura të Kosovës, të cilat janë: *Banka Qendrore e Kosovës; Zyra Kombëtare e Auditimit; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Dogana Kosovës, si dhe Autoriteti i Konkurrencës.*

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK)

Sipas përgjigjeve të pranuar, zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 kanë pranuar 46 dhurata , prej të cilave 18 dhurata protokollare, ndërsa 28 të rastit.

Vlera e 28 dhuratave të rastit të pranuar nuk është përcaktuar, vetëm thuhet se janë nën shumën prej 50 euro. Në këtë mënyrë, nuk është lënë hapësirë të vërtetohet nëse ka pasur shkelje të nenit 23, par. 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, ku kërkohet që shuma e dhuratave të rastit të pranuar brenda 1 viti nuk duhet të kalojë shifrën 250 euro.

Pavarësisht kësaj, Banka Qendrore e Kosovës nuk ka dërguar kopjen e katalogut të dhuratave të pranuar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ashtu siç e parasheh ligji.

Periudha	Numri i dhuratave të rastit	Numri i dhuratave protokollare	Njoftimi i APK-së për dhuratat e pranuar nga drejtuesi/ja i/e institucionit	Dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK
Janar – dhjetor 2023	28 	18 		

TABELA 3.

Numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës, njoftimi ose jo i APK-së, si dhe dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK.

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit gjatë vitit 2023 kanë pranuar 11 dhurata, 7 prej të cilave janë dhurata protokollare, ndërsa 4 dhurata të rastit. Vlera e tërësishme e dhuratave të rastit ishte 105 euro, ndërsa nuk është paraqitur vlera e dhuratave protokollare.

Të gjitha këto dhurata janë pranuar nga drejtues/ja e këtij institucioni, respektivisht Auditori/ja i/e Përgjithshëm/me. Neni 24, par. 2 i ligjit kërkon që në rastet kur zyrtari që pranon dhuratë është drejtues i një institucioni, ai duhet të informojë Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Mirëpo sipas informatave të pranuar nga këta të fundit, nuk ka pasur njoftim drejtuar agjencisë për çështjen e pranimit ose jo të dhuratave nga drejtuesi/ja i/e këtij institucioni.

Në anën tjetër, Zyra Kombëtare e Auditimit është i vetmi institucion, në radhët e institucioneve të monitoruara, që ka bërë deklaram të kopjes së katalogut të dhuratave për vitin 2023, obligim ky që duhet të kryhet nga institucionet deri me 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Periudha	Numri i dhuratave të rastit	Numri i dhuratave protokollare	Njoftimi i APK-së për dhuratat e pranuar nga drejtuesi/ja i/e institucionit	Dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK
Janar – dhjetor 2023	4 	7 		

TABELA 4.

Numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, njoftimi ose jo i APK-së, si dhe dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK.

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas përgjigjes së pranuar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, gjatë periudhës janar- dhjetor 2023, nuk kanë pranuar ndonjë dhuratë të rastit apo protokollare.

Në anën tjetër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e ka informuar APK-në për çështjen e pranimit ose jo të dhuratave për vitin 2023, obligim ky që duhet të kryhet nga institucionet deri me 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Periudha	Numri i dhuratave të rastit	Numri i dhuratave protokollare	Dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK
Janar – dhjetor 2023	0	0	✗

TABELA 5.

Numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njoftimi ose jo i APK-së, si dhe dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK.

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Doganës së Kosovës

Zyrtarët e Doganës së Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, sipas përgjigjeve të pranuar, kanë pranuar vetëm 1 dhuratë protokollare.

Kjo dhuratë kishte vlerë 68.72 euro, dhe e njëjta ishte pranuar nga Drejtori/ja i/e Përgjithshëm/me i/e Doganës së Kosovës. Pavarësisht se është pranuar nga drejtuesi/ja i/e institucionit, sipas informatave të pranuar nga zyrtarët e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk ka pasur njoftim drejtuar agjencisë për çështjen e pranimit ose jo të dhuratave nga drejtuesi/ja i/e këtij institucioni.

Sipas përgjigjes së zyrtarëve të Doganës së Kosovës, kjo dhuratë është vendosur në këndin e dhuratave në Doganën e Kosovës. Megjithatë, kopja e katalogut të dhuratës së pranuar nuk është deklaruar në APK, në periudhën e paraparë.

Periudha	Numri i dhuratave të rastit	Numri i dhuratave protokollare	Njoftimi i APK-së për dhuratat e pranuar nga drejtuesi/ja i/e institucionit	Dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK
Janar – dhjetor 2023	0	1	✗	✓

TABELA 6.

Numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e Doganës së Kosovës, njoftimi ose jo i APK-së, si dhe dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK.

Dhuratat e pranuar nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës

Sipas përgjigjes së zyrtarëve të Autoritetit të Konkurrencës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 asnjë zyrtar i institucionit nuk ka pranuar ndonjë dhuratë të rastit apo protokollare.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse nuk ka pasur dhurata të pranuar, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka përmbushur obligimin ligjor për të informuar Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) për pranimin ose mospranimin e dhuratave për vitin 2023.

Periudha	Numri i dhuratave të rastit	Numri i dhuratave protokollare	Dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK
Janar – dhjetor 2023	0	0	✗

TABELA 7.

Numri i dhuratave të pranuar nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës njoftimi ose jo i APK-së, si dhe dërgimi i kopjes së katalogut të dhuratave të pranuar në APK.

4. Konkluzion

Analiza e të dhënave të paraqitura në këtë raport tregon se, ndonëse disa institucione kanë bërë përpjekje për të përmbushur obligimet ligjore për raportimin e dhuratave, ekzistojnë disa mangësi të rëndësishme në implementimin e kërkesave ligjore.

Banka Qendrore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës nuk kanë përmbushur detyrimet për dërgimin e katalogut të dhuratave në APK, si dhe njoftimin në APK për dhuratat e pranuar nga drejtuesit e tyre, duke krijuar dilema mbi transparencën dhe llogaridhënien e këtyre institucioneve.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka përmbushur obligimin ligjor për të deklaruar kopjen e katalogut të dhuratave të pranuar për vitin 2023, ndërsa institucionet tjera të pavarura kanë dështuar të raportojnë kopjen e katalogut të dhuratave të pranuar apo jo, për vitin përkatës.

Po ashtu, inspektimi i kufizuar nga APK ka treguar nevojën për përmirësim në mbikëqyrjen e praktikave të pranimit të dhuratave në institucione të tjera. Këto mangësi kërkojnë vëmendje dhe përmirësim për të siguruar që të gjitha institucionet të përmbushin obligimet ligjore dhe të kontribuojnë në një ambient më transparent dhe të llogaridhënies në administratën publike.

Gjithashtu, e nevojshme është edhe përmirësimi i proceseve të raportimit dhe mbikëqyrjes për të garantuar integritetin dhe besueshmërinë në administratën publike.

5. Rekomandime

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- APK të zgjasë numrin e institucioneve të inspektuara përtej 13 institucioneve që janë vizituar gjatë vitit 2023. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e mbikëqyrjes dhe në sigurimin që të gjitha institucionet publike të përmbushin kërkesat ligjore për raportimin dhe regjistrimin e dhuratave.

- Të njoftohet APK për pranimin e dhuratave kur bëhet fjalë për drejtuesit e institucioneve, siç e kërkon neni 24, par. 2 i Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

- Të gjitha institucionet të dërgojnë në APK kopjet e katalogëve të dhuratave të pranuar deri me 31 mars të viti vijues, për vitin paraprak.

- Të publikohen raporte të rregullta mbi dhuratat e pranuar në faqet zyrtare të internetit të institucioneve. Sigurimi që informacioni të jetë i qasshëm dhe i lehtë për t'u kuptuar nga publiku.

- Të vendosen mekanizma të kontrollit të brendshëm për të monitoruar zbatimin e procedurave të deklarimit të dhuratave. Të zhvillohen auditime të rregullta nga APK për të siguruar përputhshmërinë e deklarimit me ligjin përkatës.

- Të organizohen trajnime periodike për stafin mbi rëndësinë e transparencës dhe procedurat e pranimin dhe deklarimit të dhuratave.

- Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të pavarura dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për shkëmbimin e informacioneve dhe praktikave të mira.

- Të organizohen forume dhe punëtori për të diskutuar sfidat dhe zgjidhjet në procesin e deklarimit të dhuratave.
